



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
KOMISIONERI

Nr. 674 / Prot. 6

Tiranë, më 11/09/2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 20 / datë 11/09/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.

KONSTATOVA

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë me objekt:

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave sensitive të realizuar nga kontrolluesi sipas ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Kontrolluesi Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë si kontrollues publik ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e shëndetësisë. Në ushtrim të veprimtarisë për kryerjen e shërbime spitalore publike, ndaj individëve të ndryshëm kontrolluesi mbledh, përpunon, ruan dhe administron të dhënat personale.

Kontrolli administrativ u fokusua mbi sigurinë e të dhënave, sigurinë fizike të të gjithë llojeve të kartelave të pacientëve që mban kontrolluesi, pasi në këto kartela gjenden dhe administrohen të dhëna personale dhe sensitive, në mënyrën si ato mbahen në ambientet spitalore, në arkiv /statistikë, si dhe në sigurinë e sistemit elektronik të regjistrimit të pacientëve dhe programit elektronik me të cilin funksionon arkiva/statistika.

Kështu, gjatë kontrollit administrativ grupi u njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin që kontrolluesi "Spitali Universitar "Nënë Tereza" Tiranë, mbledh dhe mban gjatë aktivitetit të tij për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale "pacientë", u shqyrtuan të gjitha llojet

e kartelave që mbahen për pacientët. U morën deklarime dhe intervista nga përfaqësues të katër departamenteve (departamenti i statistikës, ligjori, burimeve njerëzore, departamenti i marrëdhënieve me publikun dhe i teknologjisë dhe informacionit), u inspektuan ambientet, pavijonet, arkivat ku mbahen *kartelat e pacientve* pranë kontrolluesit. U administruan me cilësinë e provës në funksion të kontrollit administrativ dokumente të ndryshme që lidhen me të dhënat personale për kategorinë "*pacient*".

Për këtë kategori subjektsh të të dhënave personale në cilësinë e kontrolluesit dhe në ushtrim të funksionit tuaj të ofrimit të shërbime spitalore publike, shtrime spitalore, analiza laboratorike, urgjenca etj u kostatua se mblidhen të dhëna personale dhe informacione personale, nëpërmjet *kartelave të pacientit* të cilat janë "tip" dhe çelen për çdo pacient që kërkon shërbim pranë këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit u këqyren dhe u administruan kartela për kategorinë "*pacient*", kartela klinike, kartela ditore, kartelë klinike pranë pavijonit ORL (spitali francez). Të dhënat personale dhe informacioni personal që mblidhet për kategorinë e subjekteve të të dhënave "*pacientë*" në të gjitha kartelat që mbahen është i njëjtë dhe ato konsistojnë në mbledhjen e *emrit të pacientit, numri i identifikimit të shtetasit, kodi i pacientit, mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, gjinia, vendbanimi, grupi i gjakut, Rhezusi, të dhëna mbi personin e interesuar, informacion mbi shtrimin, diagnozën klinike, mjekun e shtrimit, sëmundje të mëparshme.*

Nga kontrolli konstatohet se kontrolluesi "*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza*" Tiranë, mbledh të dhënat e mësipërme në rrugë manuale dhe në rrugë elektronike nëpërmjet një sistemi elektronik të instaluar, si dhe ekziston një program elektronik në arkiv statistikën e kontrolluesit. Sa i përket kategorisë së të dhënave personale dhe e informacionit personal që mblidhet në këta dy mënyra për pacientët është e njëjtë, në to kërkohet për tu mbledhur; *emri, atësia, mbiemri i pacientit, data e vizitës konsultës, moshë, seksi, banues në, profesioni, kodi i pacientit, i siguruar ose jo, i rekomanduar ose jo dhe informacione të tjera* dhe nga kontrolli nuk konstatohen shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale sa i përket kategorisë së të dhënave personale që mblidhen në funksion të qëllimit të kontrolluesit dhe proporcionalitetit.

Megjithatë, nga kontrolli administrativ i kryer u konstatua se kontrolluesi "*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza*" Tiranë, nuk ka marrë masa për sigurinë fizike të *kartelave të pacientëve* të cilat mbartin të dhënat personale dhe sensitive mbi informacionin personal për pacientin. Ato u konstatuan se mbahen në zyrat e infermiereve dhe të kryeinfermiereve në rafte metalike apo mbi tavolinë dhe jo të vendosura dhe të siguruara në dollapë apo kasaforta me çelës. Pavarësisht faktit që zyrat janë me dyer dhe çelës ato në pjesën më të madhe të ditës së punës gjenden të hapura (dhe kështu u konstatuan, në pavionet që u këqyrën dhe u vëzhguan gjatë hetimit), kështu që mundësia për t'i aksesuar këto kartela të pacientëve, por dhe për ti shkatërruar është e madhe, jo vetëm nga punonjës të ndryshëm të kontrolluesit (mjekë, infermiere etj), por dhe nga individë të paautorizuar që futen në ambientet spitalore.

U konstatua mungesa e rregullave të shkruara e të përcaktuar qartë për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale në funksion të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij.

Po kështu sa i përket *sigurisë së programit elektronik në arkiv/statistikë*, konstatohet se ambienti në të cilin është vendosur serveri në departamentin e statistikave nuk është i përshtatshëm duke mos garantuar kushtet teknike minimale lidhur me ruajtjen konstante të temperaturës së ambientit dhe kufizim i aksesit fizik të serverëve nga punonjësit e këtij

departamenti. Konstatohet se nuk realizohet ruajtje të dhënash (*backup*) i sistemit dhe të dhënave të kartelave klinike të pacientëve në pajisje të veçanta dhe në ambiente të veçuara nga ai i serverit. Baza e të dhënave të sistemit menaxhohet nëpërmjet aplikacionit SQL.

Për sa i përket *sistemit elektronik të regjistrimit të pacientve*, konstatohet se ai është i sigur, aksesi në server është i kufizuar nëpërmjet "*emrit të përdoruesit*" dhe "*fjalëkalimit përkatës*". Serveri në të cilin është instaluar aplikacioni është vendosur në një ambient të përshtatshëm me akses të kufizuar, temperaturë konstante, i sigurt nga lagështia dhe me sistem alarmi ndaj zjarrit.

Grupi i kontrollit administrativ konstatoi se kontrolluesi "*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza*" Tiranë, ka lidhur kontratë shërbimi me palë të treta në funksion të ndërtimit të "*Sistemit të regjistrimit të pacientëve*", menaxhimit të tij, si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe të rrjetit të brendshëm. Në kontratën e lidhur me ofruesin e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, nuk ka të përcaktuar klauzola standarte për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, sipas ligjit nr.9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimit nr.19 datë 03/08/2012 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi"*, në të cilat pala ofruese e shërbimit ka akses mbi këto pajisje dhe sisteme kompjuterike.

Konstatohet se kontrolluesi Qendra Spitalore Universitare "*Nënë Tereza*", Tiranë mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të video vëzhgim-monitorimit (CCTV). Kryesisht kamerat janë vendosur në korridoret recepsionet dhe hollet e kontrolluesit. U konstatua se në ambientin e parashmës së Drejtorit të Përgjithshëm të kontrolluesit ka të instaluar kamera të padukshme dhe se nuk ka të vendosur tabelë paralajmëruese për mbikëqyrjen e këtij ambientit me anë të sistemit CCTV.

Kontrolluesi nuk ka rregulla të përcaktuara qartë për këtë mënyrë mbledhje dhe përpunimi të dhënash personale si kundër parashikon ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimet nr. 3 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi sistemin e video vëzhgimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*".

Sa më sipër konstatimet e evidentuara nga grupi i kontrollit administrativ dhe të pasqyruara në procesverbalin e kontrollit administrativ si të tilla janë:

1. Kontrolluesi, *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"* Tiranë, kartelat klinike të pacienteve, të cilat mbartin të dhëna personale dhe sensitive si dhe informacion konfidencial lidhur me shëndetin e pacientit, analiza, diagnoza etj, i mban në ambientet spitalore në zyrat e kryeinfermierisë, në raftet metalikë dhe mbi tavolinë, dhe jo të vendosura dhe të siguruara në dollapë apo kasaforta me çelës. Pavarësisht faktit që zyrat janë me dyer dhe çelës ato në pjesën më të madhe të ditës së punës gjenden të hapura (dhe kështu u konstatuan nga këqyrje dhe investigimet), kështu që mundësia për t'i aksesuar këto kartela të pacientëve por dhe për ti shkatërruar është e madhe, jo vetëm nga punonjës të ndryshëm të kontrolluesit (mjekë, infermierë etj), por dhe nga individë të paautorizuar që futen në ambientet spitalore çka përbën një risk të lartë të cënimit të privatësisë dhe të dhënave të pacientëve;
2. Konstatohet se ambienti në të cilin është vendosur serveri në departamentin e statistikave nuk është i përshtatshëm duke mos garantuar kushtet teknike minimale lidhur me ruajtjen konstante të temperaturës së ambientit dhe kufizim i aksesit fizik të serverëve nga punonjësit e këtij departamenti. Konstatohet se nuk realizohet ruajtje të

dhënash (backup) i sistemit dhe të dhënave të kartelave klinike të pacientëve në pajisje të veçanta dhe në ambiente të veçuara nga ai i serverit.

3. Konstatohet se ambienti fizik i cili është përdorur si arshivë për Departamentin e Statistikave, ka mungesë të kushteve fizike për ruajtjen e dokumentacionit në formatin letër. Konstatohet se dritaret (dritare të vjetra druri) nuk janë hermetikisht të mbyllura dhe ekziston mundësia e depërtimit të lagështisë nga jashtë godinës dhe për pasojë dokumentacioni/kartelat klinike të pacientëve mund të dëmtohen dhe informacioni në to të jetë i paaksesueshëm. Konstatohet gjithashtu mungesë e ndjesorëve të zjarrit/tymit, numër i pamjaftueshëm fiksesh (zjarri të përshtatshme për këtë ambient pune) si dhe tabela informuese për mospërdorim të mjeteve zjarrvënëse.
4. Në kontratën e lidhur me ofruesin e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, nuk ka të përcaktuar klauzola standarte për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, në të cilat pala ofruese e shërbimit ka akses mbi këto pajisje dhe sisteme kompjuterike.
5. Kontrolluesi, *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*, Tiranë nuk ka dhe nuk zbaton rregullore për *"Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale"*.
6. Kontrolluesi, *"Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza"*, Tiranë mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV, u konstatua në një rast vendosja në ambient e kamerave të fshehura, u konstatua se ka të vendosur njoftim për monitorimin me kamera por jo në të gjitha ambientet dhe jo sipas standardit të miratuar nga Komisioneri, nuk ka rregulla të përcaktuara qartë për këtë mënyrë mbledhje dhe përpunim të dhënash personale si kundër parashikon ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimet nr. 3 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *"Mbi sistemin e video vëzhgimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme"*

konsiderohen nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shkelje administrative që vijnë në kundërshtim me:

- **Neni 27, i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**
*"Masat për sigurinë e të dhënave personale" (Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi).
Udhëzimin nr. 3 dhe 13 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme", neni 18 i ligjit.*
- **Neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**
"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj."

Për sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

Rr. "Abdi Toptani", kati i II-të, nr. 4, Tiranë, Tel.: +355 4 2237200, www.kmdp.al

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:
 - të merren masa për sigurinë fizike të kartelave klinike të pacientëve , (të cilat mbartin të dhëna personale dhe sensitive, si dhe informacion konfidencial lidhur me shëndetin e pacientit, analiza, diagnoza etj), duke u vendosur në dollapë apo kasaforta të siguruara me çelës ne zyrat dhe pavijonet e kontrolluesit, si dhe duke kontrolluar aksesin;
 - të merren masa për sigurimin e kushteve teknike të përshtatshme për ambientin në të cilin janë vendosur serverat në departamentin e arkivë/statistikës, duke krijuar një ambient me akses të kufizuar si dhe ruajtja e temperaturës konstante me anë të kondicionimit të ajrit;
 - të merren masa që të dhënat personale të pacientëve, të cilat regjistrohen dhe përpunohen në sistemin e përdorur në arkivë/statistikë, të ruhen në pajisje te veçanta dhe kopje e tyre (*Backup*) të vendoset në një vend tjetër të sigurt jashtë vendndodhjes së serverit;
 - të merren masa për sigurinë e ambientit të arshivës fizike në Departamentin e Arkivë/Statistikë sa i përket kushteve të ambientit, lidhur me mirëmbajtjen e kartelave fizike të pacientëve nga agjentët e lagështisë, zjarrit si dhe nga dëmtimet e mundshme mekanike.
2. Në zbatim të neni 27, 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe udhëzimit nr.19 datë 03/08/2012 “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, të merren masa që në kontratat e lidhura me ofruesit e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, të vendosen, parashikohen dhe të zbatohen klauzola standarte për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave.
3. Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi *Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”* Tiranë, të hartojë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Rregullore për “*Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale*” dhe ta zbatojë atë në vijim.
4. Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe Udhëzimin nr. 3 dhe 13 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”, të hartojë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë Rregullore për qëllimin dhe mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të kamerave vëzhgim-rregjistrimi (CCTV), si dhe të bëjë informimin nëpërmjet vendosjes së tabelave informuese sipas standardit të miratuar nga Komisioneri në çdo ambjent ku ato ndodhen, veçanërisht kur ato nuk duken.
5. Kryerja e këtyre detyrave të lëna në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes së njoftimit.
6. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

7. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

